



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:078447

Datë: 04.12.2024

Numri i dokumentit: 06547434

C.nr.514/2018

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, përmes gjykatësit Blerand Rrmoku, në çështjen juridike kontestimore ndërmjet paditëses: S.M-T nga P, të cilën sipas autorizimit (prokurës) e përfaqëson S.A, avokat me seli në P, kundër të paditurës: Komuna e Prishtinës - Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit (prokurës) e përfaqëson D.GJ - Zyrtar ligjor pranë të paditurës, me objekt kontesti: anulimin e vendimit mbi përzgjedhjen e kandidatës dhe kompensimin e dëmit, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor publik me datë 25.11.2024, në prezencën e përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, me datë 04.12.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET SI E PA BAZUAR kërkesëpadia e paditëses S.M-T nga P, përmes së cilës ka kërkuar që të: *“Prishtë vendimi i të paditurës Komuna e Prishtinës - Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës në Prishtinë nr.14-111-01-17469-18 i datës 22.01.2018 mbi zgjedhjen e kandidatës I.J nga P, me 87.37 pikë për vendin e punës edukatore (vend i lirë) dhe edukatore për parafillor (zëvendësim), sipas konkursit të datës 11.12.2017, të shpallur në faqën zyrtare të Komunës së Prishtinës dhe të bëhet përzgjedhja e paditëses S.T, e cila më së miri i ka plotësuar poeant; Detyrohet e paditura që sipas konkursit të shpallur ta bëjë zgjedhjen e sërishme të kandidatëve në afat prej 8 ditëve, nën kërcënimin e përmbarimit dhe të pranohet paditësja S.T; Detyrohet e paditura, që paditëses S.T nga P t’ia kompensojë dëmin e shkaktuar nga mospranimi në marrëdhënie pune, nga data e mospranimit 22.01.2018 e deri e deri me datën e përzgjedhjes së saj.”*

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të kësaj procedure.

A r s y e t i m

- Historiku i procedurës dhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse -

Paditësja S.M-T nga P, përmes përfaqësuesit të autorizuar, S.A, avokat me seli në P, pranë kësaj Gjykate me dt.20.02.2018 ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Prishtinës - Drejtoria Komunale e Arsimit me seli në Prishtinë, me objekt kontesti anulimin e vendimit mbi përzgjedhjen e kandidatës dhe pagesën e të ardhurave personale. Si në padi, ashtu edhe përgjatë seancave të mbajtura dhe në fjalë përfundimtare, i autorizuari i paditëses ndër tjera ka pretenduar se e paditura ka shpallur konkursin në faqen zyrtare të Komunës së Prishtinës, me datë 11.12.2017 për vendin e punës edukatore (vend i lirë). Më tutje ka pretenduar se në këtë konkurs ka aplikuar paditësja me

dokumentacion të rregullt, duke pretenduar se e njëjta i plotëson të gjitha kushtet e parapara me konkurs më mirë se sa kandidatët e tjerë, duke pasur parasysh kualifikimin shkollor, trajnimet, notën mesatare dhe të gjitha kushtet tjera. Përkundër faktit që e njëjta i ka plotësuar të gjitha kushtet e parapara, pretendohet se e njëjta nuk është përzgjedhur tek lista e të pranuarve, e shpallur me datë 19.01.2018. Tutje ka shtuar se paditësja ka parashtruar ankesë tek e paditura me datë 19.01.2018, mirëpo e njëjta nuk ka pranuar asnjë përgjigje përkitazi me ankesën e parashtruar. Më tej ka pretenduar se e njëjta është diskriminuar me rastin e përzgjedhjes së kandidatës tjetër I.J, si dhe është dëmtuar në pagat mujore që është dashur t'i realizojë në rast se do të pranohej në vendin e punës, dhe atë nga data e mos pranimit të saj në këtë pozitë. Po ashtu ka shtuar se nuk ekziston asnjë mundësi që komisioni përzgjedhës të poantojë me pikë maksimale fituesen e konkursit I.J, kurse paditësen me më pak pikë, duke pasur parasysh që paditësja ka më tepër se 20 mirënjohje dhe shpërblime të fituara nga njohuritë profesionale dhe ato të përgjithshme. Më tutje ka pretenduar se e paditura ka shkëlur nenin 8 par.2 të Ligjit të Punës, ku parashihet se konkursi duhet të jetë i barabartë për të gjithë kandidatët, pa asnjë lloj diskriminimi, kurse në rastin konkret ka pretenduar se paditësja haptazi është diskriminuar nga e paditura duke mos u përzgjedhur në këtë pozitë të punës. Mbi bazën e arsyeve të latëcekura, i ka propozuar Gjykatës që të aprovohet në tërësi kërkesëpadia e paditëses, si në petitumin e përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe specifikuar.

Pala e paditur, sikurse në përgjigje në padi, ashtu edhe përgjatë seancave të mbajtura e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, duke pretenduar se e njëjta nuk ka bashkangjitur asnjë provë materiale por vetëm në mënyrë sipërfaqësore ka ushtruar padi për anulim të konkursit, duke mos dhënë ndonjë arsye të besueshme dhe të argumentueshme mbi bazën e të cilës do të vërtetoheshin pretendimet si në padi. Tutje ka pretenduar se e paditura ka zhvilluar procedurat lidhur me konkursin në fjalë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe pas vlerësimit të të gjithë kandidatëve përgjatë fazave të konkurrimit, paditësja sipas renditjes përfundimtare ka qenë e listuar në vendin e 7- të, e që rezulton se kanë qenë edhe 6 kundërkandidatë të tjerë, të cilët kanë performuar apo kanë treguar rezultate më të mira se paditësja në këtë konkurs. Mbi bazën e arsyeve të lartcekura, i ka propozuar Gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar.

Lidhur me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

- Provat e administruara dhe gjendja faktike e vërtetuar -

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, lidhur me çështjen konkrete juridike kontestimore, gjatë seancës së shqyrtimit kryesor, Gjykata ka administruar provat materiale si në vijim: *Konkursi Nr.14-111/01-0300477/17, i dt.11.12.2017; Certifikata e pjesëmarrjes, e lëshuar nga Qendra për Arsim e Kosovës; Certifikata e pjesëmarrjes, e lëshuar nga "K"; Vërtetimi i lëshuar nga Shkolla Fillore "Hasan Prishtina" në Prishtinë, Nr.745, i dt.24.07.2012; Certifikata e pjesëmarrjes, e lëshuar nga Qendra për Arsim e Kosovës; Certifikata e lëshuar nga "O" - Përfaqësia në Kosovë, e dt.03.02.2004; Vërtetimi i lëshuar nga Institucioni Parashkollor "Gëzimi Ynë" Nr.143/17, i dt.20.07.2017; Referenca e lëshuar nga Institucioni Parashkollor "Gëzimi Ynë" Nr.145/17, e dt.20.07.2017; Mirënjohja e lëshuar nga Shkolla Fillore "Hasan Prishtina", e dt.27.04.2003; Vërtetimi i lëshuar nga Qendra për Arsim e Kosovës, Nr.2056/014; Certifikata e mirënjohjes e lëshuar nga Fakulteti i Edukimit, me dt.16.05.2003; Vërtetimi i lëshuar nga Qendra*

për Arsim e Kosovës, Nr.1853/015; Referenca e lëshuar nga Shkolla Fillore "Hasan Prishtina" me dt.11.03.2015; Diploma e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës - Fakulteti Filozofik, me dt.12.02.1986; Vërtetimi i lëshuar nga Shkolla Fillore dhe e Mesme "Z", nr.protokolli 68/2015, dt.31.08.2015; Letra e referencës, e lëshuar nga SH.F.M.U "Rilindja" në Keqekollë; Formulari për ankesë; Vendimi Nr.14-111/01-17469/18, i dt.22.01.2018; Lista e kandidatëve të emëruar sipas konkursit të dt.12.12.2017 për pozitat në institucionet edukativo - arsimore dhe aftësuese në Komunën e Prishtinës; Vendimi Nr.14-020/04-0303802/17, i dt.14.12.2017; Renditja përfundimtare e kandidatëve; Njoftimi Nr.14-020/01-31209/18, i dt.05.01.2018; Njoftimi Nr.14-111/01-12715/18, i dt.16.01.2018; Formularët e vlerësimit të kandidatës I.J; Formulari i aplikimit për punësim për kandidaten I.J, Nr.14-111/01-0308945/17, së bashku me dosjen e kandidatës; Deklarata e dëshmitarit H.B në seancën e datës 11.11.2024 dhe Deklarata e paditëses S.M-T, e dëgjuar në cilësinë e palës në seancën e datës 11.11.2024.

Gjykata pasi bëri vlerësimin e secilit pretendim të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 7 dhe 8 të Ligjit Nr.03-L/006 të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes të veçantë dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç si dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e pa bazuar, ndaj të njëjtën e refuzoi në tërësi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në vijim, Gjykata do të trajtojë dhe do të japë vlerësim për secilën pikë të kërkesëpadisë së paditëses veç e veç, duke shtjelluar faktet që kanë qenë relevante dhe me peshë vendimtare në lidhje me një vendosje të tillë.

Nga provat e administruara dhe pohimet e palëve, Gjykatës i rezulton se në mes të palëve ndërgjyqëse nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësja kishte aplikuar në Konkursin e shpallur nga e paditura me Nr.14-111/01-0300477/17, të datës 11.12.2017, në pozitën “Edukatore në IP” - vend i lirë si dhe fakti që për këtë pozitë së punës, pas përfundimit të procedurave të vlerësimit është shpallur fituese kundërkandidatja e paditëses, znj. I.J, e cila në total ka fituar 86.36 pikë, kurse paditësja është renditur e 7- ta në listë me gjithsej 77.14 pikë.

Nga Formulari i aplikimit për punësim për kandidaten I.J, Nr.14-111/01-0308945/17, së bashku me dosjen e kandidatës së lartcekur, Gjykata vërtetoi faktin se e lartëcekura ka aplikuar për pozitën e punës “Edukatore në IP - vend i lirë” në Konkursin e shpallur nga e paditura me Nr.14-111/01-0300477/17 e datës 11.12.2017, si dhe ka të bashkangjitur dokumentacionin e nevojshëm për procedim të mëtejshëm në këtë konkurs. Po ashtu, nga Diploma Nr. 641/17 e datës 06.07.2017 e lëshuar nga “Kolegji A”, Gjykata ka gjetur se znj. I.J ka përfunduar studimet themelore / të nivelit Bachelor në Fakultetin e Shkencave Sociale dhe ka fituar titullin: “Bachelor në Përkujdesje dhe Mirëqenie Sociale të Fëmijëve”. Po ashtu, nga formularët e vlerësimit individual të kandidatëve nga ana e secilit anëtar të komisionit përzgjedhës, Gjykata vërtetoi se mesatarja e pikëve për kundërkandidatën I.J është 86.36 pikë në total, duke dalur e para kundrejt kandidatëve të tjerë - përfshirë këtu edhe paditësen.

Gjykata përgjatë procedurës provuese e ka dëgjuar në cilësi të dëshmitarit edhe H.B nga P, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit Përzgjedhës për Konkursin e lartpërmendur, dhe ka dëgjuar paditësen në cilësi të palës në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 11.11.2024.

Dëshmitari H.B, në dëshminë e dhënë në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.11.11.2024, ka deklaruar se si çdo konkurs tjetër publik, është shpallur edhe konkursi kontestues, janë zhvilluar procedurat në bazë të dispozitave ligjore, të përcaktuara për nënpunës publik, është mbajtur testi me shkrim dhe intervista me gojë dhe në bazë të vlerësimit të të gjitha anëtarëve të komisionit ka dalë fituese kandidatja znj. I.J. Në pyetjet e parashtruara lidhur me kualifikimin e tij, dëshmitari është përgjigjur se ka të përfunduar studimet e nivelit Master në shkencë juridike dhe politike, duke shtuar se në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 të MPMS, nuk janë të përcaktuara kualifikimet e anëtarëve të komisionit, ndërsa si pjesë e burimeve njerëzore ka qenë i obliguar të marrë pjesë në atë komision. Në pyetjen e parashtruar lidhur me kriteret e vlerësimit të kandidatëve, dëshmitari është përgjigjur se të njejtat kanë qenë të përcaktuara në konkursin publik të shpallur, që nga kriteret bazike për kalim në fazat tjera, ndërsa vlerësimi i testit me shkrim dhe intervistës me gojë bëhet sipas përgjigjeve të dhëna nga kandidatët në pyetjet e parashtruara. Sa i përket pyetjeve, ka theksuar se janë përzgjedhur nga komisioni dhe kanë qenë të njejtat për të gjithë kandidatët. Në pyetjen nëse vlerëson që është bërë ndonjë lëshim në vlerësimin e kandidatëve, i njejtë është përgjigjur se nuk është i mendimit që kemi të bëjmë me lëshime të tilla, pasi vlerësimet janë të konstatuara në formularë të vlerësimit dhe janë pjesë e dosjes së lëndës.

Paditësja S.M-T, e dëgjuar në cilësinë e palës në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.11.11.2024 ka deklaruar se ka aplikuar në konkurs me një dosje voluminoze, e cila gjendet në shkresat e lëndës dhe konsideron se i ka plotësuar të gjitha kushtet e parapara. Tutje ka shtuar se ka punuar për 6 vite në fshatin Keqekollë si pedagog shkolle, për 17 vite në shkollën fillore “Hasan Prishtina” si mësuese klasore, 6 vite në shkollën private “Z” në fshatin P. Më tej ka theksuar se si edukatore, krahas përvojës ka edhe mirënjohje të shumta, si dhe ka përfunduar avancimin 1 vjeçar, që plotëson edhe më shumë kushtet e konkursit, por krahas kësaj mbetet pa punë nga vlerësimi që konsideron se është jo i duhur nga anëtarët e komisionit, për të cilët vlerëson se nuk kanë qenë kompetent për ta vlerësuar në aspektin profesional. Tutje ka shtuar se me njëjërën nga anëtarët e komisionit ka punuar 1 vit dhe e njëjta i ka dhënë referencën me pikë maksimale, por në komision i janë mohuar vlerat që i janë dhënë, si dhe nuk i është vlerësuar përvoja e punës dhe njohuritë profesionale.

Gjykata bëri shtjellimin e të gjitha provave të parashtruara nga palët ndërgjyqëse, kurse kryesisht në pjesën arsyetuese, u është referuar provave që kishin ndikim vendimtar në vendosje si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

- Vlerësimet faktike dhe juridike të Gjykatës -

Nga vërtetimi i gjendjes faktike si më lartë, Gjykata gjen të nevojshme të sqarojë se objekt argumentimi fillimisht paraqitet kërkesa e paditëses për *“prishjen e vendimit të të paditurës mbi zgjedhjen e kandidatës I.J si dhe përzgjedhjen e paditëses në këtë pozitë”*, e më pas edhe kërkesa e të njejtës për kompensimin e të ardhurave personale si pasojë e mos përzgjedhjes në konkursin për pozitën e punës: *“Edukatorë në IP”*, për të cilat palët ndërgjyqëse kanë paraqitur pikëpamje dhe argumente të ndryshme nga njëra - tjetra.

A) *Lidhur me kërkesën për prishjen e vendimit përkitazi me përzgjedhjen e kandidatës I.J dhe kërkesën për ta detyruar të paditurën ta përzgjedhë paditësen në vendin e punës “Edukatorë në IP”.*

Fillimisht, Gjykata vlerëson se në kontestet të cilat burojnë nga marrëdhënia e punës, cenimi i të drejtave të pretenduara të cilat burojnë nga kjo materie, mund të vijë në shprehje përmes nxjerrjes së vendimeve apo akteve të ndryshme nga ana e subjektit punëdhënës. Rrjedhimisht, mbrojtja gjyqësore duhet të konsistojë në kërkesën për anulimin e vendimeve të tilla, mbi bazën e të cilave krijohet hapësirë për caktimin e ndonjë kompensimi të arsyeshëm të karakterit monetar, nënkuptohet mbi bazën e argumentimit të plotë të faktit se është cenuar ndonjë e drejtë. Në rastin konkret, Gjykata gjen se pala paditëse me palën e paditur nuk kanë të themeluar marrëdhënie pune, rrjedhimisht nuk gjenden në raportin juridik punëdhënës - punëmarrës. Megjithatë, standardet e lartcekura aplikohen në mënyrë të ngjashme edhe në rastet kur *synohet* të themelohet marrëdhënia e punës, që nënkupton se subjektit i cili pretendon dhe synon të themelojë marrëdhënie pune, mund t'i cenohet ndonjë e drejtë nga ana e subjektit i cili ka shpallur konkurs për themelimin e marrëdhënies së punës. Po ashtu, Gjykata sjellë në vëmendje faktin se shpallja e konkursit, si akt në vetvete në aspektin procedural nuk është i përfshirë me elemente të kundërligjshme dhe nuk cenon ndonjë të drejtë nga marrëdhënia e punës. Një veprim i tillë për më tepër është në harmoni me dispozitën nga neni 8 par.1 të Ligjit të Punës, si dhe nenit 17 pika h) e *Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale* ku parashihet se “Komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuar në legjislacionin e zbatueshëm, në fushat që vijnë ... h) ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e rrogave dhe trainimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit”. Po ashtu, me Ligjin për Arsimin në Komunitet e Kosovës, në nenin 4 par.1 parashihet që: “Komunitet kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për atë që ato i takojnë interesit lokal, ndërkohë që respekton standardet e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi në lidhje me dispozitat e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve arsimore, marrjen në punë, pagesën e rrogave dhe aftësimin e mësimdhënësve dhe administratorëve”, kurse me nenin 5 pika c) të të njëjtit ligj parashihet se: “Kompetencat e referuara në Nenin 4 të këtij ligji përfshijnë kompetencat e mëposhtme të veçanta komunale në arsimin publik për nivelet 0 (parashkollor), 1 (fillor), 2 (të mesëm të ulët) dhe 3 (të mesëm të lartë) në pajtim me udhëzimet dhe/ose procedurat dhe standardet e përgjithshme të shpallura nga MASHT-i: punësimin e mësimdhënësve dhe personelit tjetër të shkollave në pajtueshmëri me procedurat ligjore të rekrutimit, përzgjedhjes dhe punësimit të të punësuarve publikë”.

Në rastin konkret, Gjykata vlerëson se bazuar në faktin se e paditura ka cilësinë e personit juridik publik, e njëjta sipas vlerësimeve dhe planifikimeve të saja ka shpallur konkurs për punësim si në rastin konkret për plotësimin e vendeve të lira të punës. Thënë kjo, sipas vlerësimit të Gjykatës, veprimet dhe aktet të cilat burojnë nga konkursi i shpallur, mund të paraqesin objekt trajtimi në kontekstin e vlerësimit nëse është ndjekur procedura dhe janë respektuar standardet e përcaktuara me dispozitat e akteve normative që e rregullojnë ecurinë e një procedure të tillë.

Kriteret kualifikuese të cilat duhet të përmbushen për tu përzgjedhur në pozitën “Edukatore në IP”, për të cilën ka aplikuar edhe paditësja, janë të përcaktuara me kriteret e konkursit Nr.14-111/01-0300477/17, të datës 11.12.2017 të titulluar “Kriteret e Kualifikimit për edukatore (3-6) – Fakulteti i Edukimit - Programi para fillor; Shkolla e Lartë Pedagogjike - Drejtimi për edukatorë; Fakulteti Filozofik - Dega e Pedagogjisë; Fakulteti i Shkencave Sociale - Programi për kujdesja dhe mirëqenia e fëmijëve;” Po ashtu, në të njëjtin konkurs për kandidatët që hyjnë në rrethin e ngushtë do të vlerësohen sipas kriterëve në vijim: “Njohuritë e Përgjithshme me 25 pikë, Aftësitë e Përgjithshme

dhe Personalitetit 35 pikë dhe Njohuritë profesionale 40 pikë (ku përfshihen përvoja e punës dhe nota mesatare gjatë studimeve)."

Në rastin konkret, paditësja ka aplikuar për pozitën "Edukatore në Institucionet Parashkollore" në kuadër të të paditurës. Nga diploma Nr.5318, e datës 12.02.1986, Gjykata gjeti se paditësja ka diplomuar në Fakultetin Filozofik, ndërsa është renditur në vendin e 7-të në listën përfundimtare të shpallur nga e paditura me pikë totale prej 77.14 të fituara nga intervista e zhvilluar me datë 13.01.2018. Sa i përket kandidatës së përzgjedhur, Gjykata gjeti se e njejta sipas aplikacionit Nr.14-111/01-0308945/17, të datës 20.12.2017 ka aplikuar brenda afatit të konkursit për pozitën "Edukatore në IP", ndërsa sipas Diplomës Nr.641/17, të datës 06.07.2017 (autenticiteti i së cilës është vërtetuar sipas aktit noterial LRP.nr.23237/17 i datës 19.12.2017 e lëshuar nga Noteri I.I), rezulton se e njejta ka përfunduar studimet themelore / të nivelit Bachelor në Fakultetin e Shkencave Sociale dhe ka fituar titullin: "Bachelor në Përkujdesje dhe mirëqenie sociale", kurse nga intervista e zhvilluar me datë 13.01.2018 pranë komisionit përzgjedhës ka fituar total 86.36 pikë.

Së këndejmi, Gjykata rikujton se paditësja ka kërkuar fillimisht që të priset vendimi i të paditurës përkritazi me zgjedhjen e kundërkandidatës I.J nga P në pozitën e punës "Edukatore në IP" dhe të bëhet përzgjedhja e paditëses në këtë pozitë të punës.

Një kërkesë të tillë, kjo Gjykatë e vlerëson si të pabazuar në pikëpamje juridike. Gjykata këtë vlerësim e mbështetë tek dispozitat e Ligjit Nr.03/L-212 të Punës (më tutje referuar si LP) i cili paraqet ligj të zbatueshëm, ku në frymën e dispozitës së nenit 2 par.1, përcaktohet që: "*Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të punësuarit dhe punëdhënësit e sektorit privat dhe publik në Republikën e Kosovës*". Dispozita e nenit 8 par.1 e të LP-së përcakton që: "*Punëdhënësi në sektorin publik, është i obliguar që të shpallë konkurs publik sa herë që pranon një punëmarrës dhe themelon një marrëdhënie të punës*". Së këndejmi, në rrethanat faktike të rastit konkret, kërkesa e palës paditëse që të priset vendimi i të paditurës vetëm përkritazi me përzgjedhjen e kundërkandidatës tjetër të paditëses, znj. I.J dhe përzgjedhjen e paditëses në pozitën e punës "Edukatore në IP", nuk gjen mbështetje ligjore në asnjërën prej dispozitave të Ligjit të Punës dhe dispozitave tjera të aplikueshme të lartëcituarra në rastin konkret. Kandidatja I.J rezulton të ketë kualifikimin e kërkuar dhe sipas vlerësimit të lirë dhe diskrecional të komisionit përzgjedhës ka arritur të fitojë pikët e nevojshme në konkursin përkatës. Gjykata nuk ka gjetur ndonjë parregullsi, qoftë procedurale apo materiale përgjatë tërë procedurës së konkursit. Për më tepër, e paditura, në përputhje të plotë me dispozitat ligjore të lartëcekura si dhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik (i cili ka operacionalizuar më tutje procedurën e konkurrimit dhe themelimit të marrëdhënies së punës në sektorin publik), ka shpallur dhe ndjekur të gjitha fazat e nevojshme të procedurës, intervistuar dhe përzgjedhur kandidatët më të suksesshëm sipas vlerësimit të Komisionit Përzgjedhës për të gjitha pozitat që kanë qenë të hapura me konkursin në fjalë. Në këtë linjë argumentimi, Gjykata e sheh të nevojshme të nënvizojë faktin se është në diskrecionin e plotë të komisionit përzgjedhës që të kryejë vlerësimin, respektivisht poentimin e kandidatëve në raport me pergjigjet e dhëna, gjithnjë duke marrë në konsideratë procedurat dhe kriteret ligjore të zbatueshme në rastin konkret, kurse ndërhyrja e Gjykatës në vlerësimin subjektiv të komisionit përzgjedhës do të nënkuptonte *cenim të hapësirës së lirë vlerësuese* që i takon të paditurës për të përzgjedhur kandidatët që i vlerëson si adekuat për pozitat e lira të punës. Sa i përket kërkesës së paditëses që e njejta të përzgjidhet si fituese e konkursit, në rrethanat e rastit konkret, do të vinte në shprehje edhe *detyrimi* i dhënë për të paditurën për të lidhur Kontratë Pune përmes një

ndërhyrje të tillë. Është mirëfilli i njohur parimi se lidhja e kontratës së punës i nënshtrohet *vullnetit të lirë* të palëve sipas kufizimeve të cilat i parasheh Ligji i Punës, e jo *urdhërit* apo *detyrimin* nga ana e Gjykatës, andaj sipas vullnetit të lirë palëve, gjithnjë duke u respektuar dispozitat ligjore dhe kufijtë e përcaktuar, palët mund të shprehin vullnetin për themelimin e marrëdhënies së punës dhe marrjen përsipër të të drejtave dhe detyrimeve të ndërsjella nga marrëdhënia e punës.

B) Lidhur me kërkesën e kompensimit të pagave nga data e mos pranimit në punë e deri në ditën e përzgjedhjes së saj

Lidhur me kërkesën e paditëses që të detyrohet e paditura që paditëses t'ia paguajë pagat si pasojë e dëmit të shkaktuar nga mos përzgjedhja e saj në pozitën e punës që është objekt i këtij kontesti, Gjykata vlerëson se një kërkesë e tillë nuk parashihet në nenin 80 të LP-së, i cili parasheh që: “1. Nëse gjykata konstaton se ndërprerja e kontratës së punës nga ana e punëdhënësit është joligjore, në bazë të dispozitave të këtij ligji, Kontratës Kolektive ose Kontratës së Punës, atëherë do të urdhërojë punëdhënësin që të ekzekutojë njërën prej këtyre dëmshpërblimeve: 1.1. t'i paguajë të punësuarve kompensimin, përveç shtesave dhe shumave tjera të cilat i takojnë punonjësit në bazë të këtij ligji, Kontratës së Punës, Kontratës Kolektive ose Aktit të Brendshëm, në shuma të tilla që gjykata i konsideron të drejta dhe adekuate, por të cilat nuk duhet të jenë më pak se dyfishi i vlerës së çdo dëmshpërblimi që i takon punonjësit në kohën e shkarkimit; ose 1.2. nëse largimi nga puna vlerësohet si i paligjshëm sipas nenit 5 të këtij ligji, Gjykata mund ta rikthejë të punësuarin në vendin e tij të punës dhe urdhëron kompensimin e të gjitha pagave dhe përfitimeve tjera të humbura gjatë gjithë kohës së largimit të paligjshëm nga puna”. Në kuptim të kësaj dispozite ligjore, në kontestet juridike që burojnë nga marrëdhënia e punës, Gjykata kufizohet në vlerësimin nëse e paditura ka ndërprerë kundërligjshëm marrëdhënien e punës të punësuarit dhe në rast se provohet kundërligjshmëria në ndërprerjen e marrëdhënies së punës, atëherë Gjykata urdhëron kompensimin adekuat për të punësuarin, siç edhe është përcaktuar në nenin 80, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1. të LP-së. Kthimin në vendin e punës, Gjykata mund ta urdhërojë vetëm në rastet kur të punësuarit i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të *diskriminimit* nga cilado bazë, siç edhe është përcaktuar në nenin 80, par.1, nënpar 1.2 lidhur me nenin 5 të LP-së, ndërsa Gjykata veçse ka vlerësuar se është e pabazuar kërkesa përkitazi e detyrimit të paditurës që ta përzgjedhë në pozitën e punës “Edukatore në IP”. Në një situatë të tillë faktike, konstatimi si i paligjshëm dhe anulimi i një vendimi të punëdhënësit (këtu të paditurës), lidhur me mos përzgjedhjen e paditëses në marrëdhënie të punës, është kusht *sine quo non* dhe *vendimtar* për të urdhëruar përmbushjen e cilitdo detyrim sa i përket kompensimit të të ardhurave personale të paditëses. Madje, përkitazi me lartësinë e një kërkesë të tillë i autorizuari i paditëses përgjatë seancave të mbajtura nuk i ka propozuar Gjykatës ndonjë mjet provues me të cilën do të saktësohej lartësia e një kërkesë të tillë. Për më tepër, Gjykata vlerëson se në rastin konkret kontestimor, para Gjykatës nuk ka një kërkesë të *kthimit në vendin e punës*, por ka kërkesë që të detyrohet e paditura ta *përzgjedhë* paditësen në vendin e punës të cekur si më lartë, andaj kërkesa për kompensimin e pagave dhe beneficioneve tjera që burojnë nga marrëdhënia e punës, bazuar në vlerësimet dhe dispozitat ligjore të lartcekura, Gjykata i vlerëson si të pa bazuara.

Gjykata trajtoi me vëmendje pretendimet e të autorizuarit të palës paditëse lidhur me faktin se e njëjta ka përvojë të gjatë si mësimdhënëse, ka mirënjohje të shumta dhe vlerësime pozitive përgjatë gjithë karrierës, të cilat nuk janë trajtuar dhe nuk janë marrë fare parasysh në raportin mbi aktivitetin hulumtues, shkencor dhe profesional të kandidatës. Në raport me këto pretendime, Gjykata konstatoi

se nga provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës rezultojnë që përvoja e punës së paditëses, respektivisht pjesëmarrja e të njëjtës në trajnime, aktivitete dhe vlerësimet pozitive për punën e saj janë të një niveli tejet të respektueshëm. Megjithatë, Gjykata vlerëson se kriteret e tilla nuk kanë shërbyer si të vetme në funksion të vlerësimit të faktit nëse paditësja i plotëson kushtet për tu përzgjedhur në pozitën në të cilën ka aplikuar, rrjedhimisht nuk mund ta kenë penalizuar të njëjtën për tu përzgjedhur në këtë pozitë (*argumentum a contriario*), mungesa e përvojës, trajnimeve apo vlerësimeve në punë paraprake të kandidatës I.J, nuk mund ta penalizojnë të njëjtën për tu përzgjedhur në këtë vend të punës.

Gjykata mori në konsideratë faktin se në referatin e padisë, janë ngritur pretendime që konsistojnë në faktin se paditësja i është nënshtruar diskriminimit nga ana e të paditurës me rastin e mos përzgjedhjes së të njëjtës si kandidate fituese në konkursin e hapur. Në raport me këto pretendime, Gjykata në aspektin e të drejtës materiale iu referua Ligjit Nr.05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, i publikuar në Gazetën Zyrtare me dt.28.05.2015, i cili në nenin 1, ku flitet për qëllimin e ligjit përcakton që: *“Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i një kornize të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatëzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë.”* Tutje, neni 4 përcakton që: *“1.1. Diskriminimi i drejtpërdrejtë konsiderohet kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa trajtohet, ka qenë i trajtuar ose do të trajtohet një person tjetër në një situatë të krahasueshme, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji; 1.2. Diskriminimi i tërthortë konsiderohet kur, një dispozitë, kriter apo praktikë e paanshme në dukje e vë, e ka vënë apo do ta vë personin në pozitë të pabarabartë krahasuar me të tjerët, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, përveç në rastet kur dispozita, praktika apo kriteri i tillë mund të arsyetohet në pikëpamje objektive me një qëllim legjitim, dhe mjetet për arritjen e qëllimit janë të përshtatshme dhe domosdoshme.”*

Gjykata vlerëson se pala paditëse duhet të përcaktojë dhe shpjegojë saktësisht ndonjë bazë të diskriminimit dhe të ndërtojë rastin në mënyrë të vlefshme në drejtim të argumentimit të trajtimit të pa barabartë ose diskriminues nga ana e të paditurës. (shih kështu *Aktvendim për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese në rastet nr. KI65/20 dhe KI66/20, i datës 15.01.2021*). Së këndejmi, sipas vlerësimit të gjykatës, paditësja nuk ka arritur që para gjykatës të shpjegojë dhe artikulojë saktësisht se mbi cilën bazë pretendon të jetë diskriminuar dhe cila e drejtë i është cenuar si rezultat i veprimit të pretenduar diskriminues. Gjykata vlerëson se sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, pretendimet e paditësit përkojnë me diskriminim të tërthortë dhe jo të drejtpërdrejtë. Diskriminimi i tërthortë mund të marrë formën e efekteve paragjyqëse në mënyrë disproporcionale të një politike ose mase të përgjithshme e cila, edhe pse e shprehur në terma neutralë, ka një efekt të veçantë diskriminues ndaj një grupi të caktuar (*Biao kundër Danimarkës [DHM], 2016; D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke [DHM], 2007, Sampanis dhe të tjerët kundër Greqisë, 2008*).

Për më tepër, Gjykata i referohet edhe nenit 5 par.3 të Ligjit të Punës, i cili decidivisht përcakton që: *“Nuk konsiderohet diskriminim, çdo dallim përjashtim ose dhënie e përparësisë, përkitazi me ndonjë vend të caktuar pune, në bazë të kriterëve të caktuara që kërkohen për atë vend pune.”*

Bazuar në konstatimet e mësipërme, u vendos decidivisht si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ashtu që u refuzua në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditëses.

- *Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës* -

Vendimin që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta të kësaj procedure, nga pika II e dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore nga nenet 450, lidhur me nenin 463.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, për faktin se pala paditëse e ka humbur kontestin gjyqësor, kurse pala e paditur, si palë gjyqfituese, nuk ka paraqitur kërkesë të specifikuar lidhur me shpenzimet e procedurës.

Mbi bazën e të lartcekurave, në mbështetje të dispozitave nga nenet 142, 143, lidhur me nenin 160 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL -
C.nr.514/18, datë 04.12.2024

Gjyqtari,
Blerand Rrmoku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, në kuptim të dispozitës nga neni 477 të LPK-së është e lejuar ankesa, në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.